



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PËR SHËRBIME

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga “Fadil Ferati” në njërën anë;

Dhe

”TE SALIHU” Shpk me NRB 8102101621 me nga Sudenica të cilën e perfaqëson z. Edon Shoshi, në cilësinë e Drejtorit të ndermarrjës nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për:

TITULLI I KONTRATËS

TRANSPORTI I NXËNËSVE DHE MËSIMDHENESVE NE RELACIONE TE NDRYSHME

Nr. I prokurimit	633 – 019 - 3173- 2-3-6 c 211
I brendshëm	633 - 019 – 033 - 236 c 198

Neni 1

Lënda

1.1 TRANSPORTI I NXËNËSVE DHE MËSIMDHENESVE NE RELACIONE TE NDRYSHME

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 15.06.2019 dhe përfundon me 14.06.2020

1.3 Afati kohor i kryerjes së SHËRBIMEVE nuk mund të jetë më shumë se 12 Muaj nga data efektive e nënshkrimit të Kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes se sherbimeve do te jetë në Istog.

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 4.700,00 €;
Me shkronja “Katërmijë/shtatëind/zero zero euro”**

Çmimi është i dhënë per njësi (Km) 0.90 euro

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale të pagesës pas kryerjes së shërbimeve

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Nuk aplikohet

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë njërin ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të

drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund t'i drejtohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik,

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Tribunalin e Perehershëm i Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Kosovës.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.





E hartuar në gjuhën Shqipe dhe Serbisht në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për: Operatorin Ekonomik

“Te Salihu” N.T.T

Për: Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Emri:	Edon Shoshi	Emri:	Zizë Bujupaj
Pozita:	M e n a x h e r	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.06.2019	Data:	14.6.2019
Vula:		Vula:	

KOMUNA E ISTOGUT			
TRANSPORTI I NXENESVE DHE MESIMDHENESVE NE RELACIONE TE NDRYSHME			
PARAMASA DHE PARALLOGARIA			
TRANSPORTI I NXENESVE DHE MESIMDHENESVE NE RELACIONE TE NDRYSHME			
Nr.rend.	PERSHKRIMI	Njesia	Sasia e paraferit
		km	Gmimi per njesi
1	Transport per nevojat e institucioneve komunale dhe anasjelltas (nxenes ne gara te ndryshme, mesimdhenas ne		5000
			0,90



* GIMI NJESI ËSHTE HLOGARITUR
 PA TVSH! SEPSE FIRMA DON
 NUK ËSHTE E REXHISTRUAR NE TVSH
 KONFORM LIGJEVE TE ADMINISTRATES
 TATI MORE TE KOSOVES.